VENDIM
Nr. 91, datë 28.4.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "KURUM INTERNATIONAL" SHA, ME NR. 372, SERIA F12/17, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 106, DATË 20.7.2012, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/2 prot., datë 20.4.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë 'Kurum International' sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Kurum International" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 404/1 prot., datë 5.4.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c", plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d", plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: "a", "c", "d", "e", "f", plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Tiranë për vetë shoqërinë, administratorin e saj dhe përfaqësuesin ligjor;

Dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa "g" (dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve.) Shoqëria nuk ka përcjellë dokumente në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t'i kërkohet t'i depozitojë në ERE;

- germa "h" (të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar). Shoqëria nuk ka përcjellë dokumente në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t'i kërkohet t'i depozitojë të dhënat në ERE;

- germa "i" (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). Shoqëria nuk ka përcjelle dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, do t'i kërkohet ta depozitojë në ERE.

- Shoqëria, në zbatim të nenit 7, pika 2, germa "a", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, duhet të përcjellë në ERE prokurën ose autorizimin për përfaqësimin e saj në ERE, sipas deklarimit të bërë nga vetë ajo në formatin e aplikimit, do të njoftohet shoqëria që t'i përcjellë në ERE, brenda afateve, dokumentet në zbatim të rregullores.

- Shoqëria "Kurum International" sh.a. është mbajtëse e licencës nr. 372, seria F12/17, në veprimtarinë së furnizimit të energjisë elektrike që nga data 20.7.2012, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, të ndryshuar me vendimin nr. 87, datë 7.6.2017, me afat vlefshmërie deri më datë 7.6.2022.

- Në nenin 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 5.4.2022, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Shoqëria "Kurum International" sh.a. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 372, seria F12/17, të shoqërisë "Kurum International" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012, të ndryshuar, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 8.6.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti